

Arsimi mund ta transformojë botën

“Arsimi është e drejtë fundamentale, e jo privilegj. Unë dua t’iu ndihmoj fëmijëve ta kuptojnë fuqinë e arsimit dhe potencialin e tij për transformim të jetës”

Ayswarrya Ganapathiraman
Shkolla Percutz, Brazil

Arsimi mund ta transformojë botën

Lënda

Shoqëri, Edukim qytetar, Gjeografi, Zhvillim gjuhësor

Rezultatet e mësimit

- Të kuptohet fuqia e arsimit për ndryshim të jetës
- Të dihet se askush nuk ka qasje të njëjtë në arsim
- Të interpretohen të dhëna global për arsim (edukim) duke përdorë vizualizim nga interneti
- Të praktikohen teknika motivuese të shkrimit
- Të promovohet qasja e barabartë në arsim për të gjithë njerëzit anekënd botës

Përgatitja

- Paraqiteni ose shtypeni hartën e përdorë në aktivitetin e dytë
- Përgatitni fletë për vizatim

Koha e përgjithshme:

60 minuta

Mosha:

11-14

Arsimi mund ta transformojë botën

Aktiviteti mësimor

20 minuta

Ndani nxënësit në grupe me nga 3 ose 4 persona. Kërkoni nga secili grup të vizatojnë nga një figurë të madhe të njeriut. Kërkoni nga ata të mendojnë për cilësitë dhe karakteristikat, që mund t'i ketë ndonjë person i arsimuar. Nxënësit duhet t'i shënojnë ato brenda figurës së personit të vizatuar.

Pastaj kërkoni nga nxënësit të vizatojnë një rreth të madh përreth figurës së vizatuar, që do ta simbolizojë botën. Nxënësit duhet të diskutojnë dhe të shënojnë se cilat do të jenë cilësitë dhe karakteristikat e botës së mbushur me persona të arsimuar. Nxënësit mund po ashtu të shtojnë fotografi dhe simbole në vizatimet e tyre.

Kërkoni nga grupet e nxënësve t'i ndajnë idetë e tyre me të tjerët.

Kërkoni nga nxënësit të punojnë së bashku në çifte dhe të mendojnë rreth mundësive që mund të krijohen si rezultat i ndjekjes së arsimit cilësor. Kërkoni nga ata të paraqesin një listë prej 5 mundësive dhe ta prezantojnë atë para nxënësve të klasës.

Diferencimi dhe alternativat

Nëse keni në dispozicion hapësirë të mjaftueshme dhe fletë të madhe, atëherë nxënësit do të mund të vizatojnë figurën e ndonjë nxënësi të klasës, i cili do të shtrihet mbi fletën e madhe të vizatim të vënë në dysheme, në vend se të vizatojnë një figurë të imagjinuar të njeriut.

Klasa mund ta ruajë (regjistrojë) listën e karakteristikave dhe të vendos për 10 karakteristikat kryesore.

Tregojani nxënësve disa fakte befasuese në lidhje me pasojat e ndjekjes së arsimit të mirë - shtojca 1.

Aktiviteti mësimor

20 minuta

Paraqitni ose ndani kopje të shtojcës 2, në të cilën është dhënë një hartë me ndarje jo të barabartë të arsimit anekënd botës.

Pyetni nxënësit të diskutojnë rreth këtyre pyetjeve:

Çka paraqesin të dhënat në lidhje me qasjen në arsim në shtetin dhe kontinentin e tyre?

Si qëndrojnë këta të dhëna në raport me shtetet dhe kontinentet tjera?

Çka paraqet harta në lidhje me nivelet e arsimit ose qasjen në arsim në gjithë botën?

A mendojnë nxënësit se anekënd botës ka qasje të drejtë në arsim?

Arsimi mund ta transformojë botën

Vërejtje: Nëse duhet të ofrosh hartë tjetër të botës, në të cilën janë shënuar emrat e shteteve dhe kontinenteve, atëherë mund ta përdorni shtojcën 3.

Diferencimi dhe alternativat

Për t'i mbështetur nxënësit më të rinj dhe me më pak afinitet, parashtroni pyetje specifike në lidhje me të dhënat, ose shënoni një sërë deklaratash në lidhje me të dhënat, ndërsa nxënësit duhet të thonë nëse deklaratat janë të sakta ose jo të sakta.

Arsimi mund ta transformojë botën

Aktiviteti mësimor

Prezantoni Qëllimet Globale duke shpjeguar se ato janë një pako të synimeve të përcaktuara në shtator të vitit 2015, që kanë për qëllim t'i vënë fund varfërisë ekstreme për secilin dhe t'i parandalojnë ndryshimet klimatike. Njëri ndër Qëllimet Globale është që secili të ketë qasje në arsim cilësor. Kërkoni nga nxënësit t'ia shkruajnë një letër ndonjë politikani lokal ose shtetëror, përmes së cilës do të kërkojnë nga përfaqësuesi politik t'i mbështet Qëllimet Globale. Në letrën e tyre nxënësit duhet t'i citojnë disa nga të dhënat e aktivitetit paraprak. Nxënësit duhet të shpjegojnë pse mendojnë se ky Qëllim Global ka rëndësi të veçantë, si dhe duhet të përdorin shembuj për t'i zgjeruar idetë e tyre. Nxënësit duhet të vizatojnë teknika motivuese me shkrim.

Diferencimi dhe alternativat

Nxënësve më të rinj dhe me më pak afinitete jepuni fjali të filluara dhe/ose përshkrim të përmbajtjes për secilin paragraf të letrës së tyre.

Ndërmerrni masa për Qëllimet globale

Si edukator keni fuqinë t'i kanalizoni energjitë pozitive të nxënësve dhe t'iu ndihmoni atyre të besojnë se nuk janë të pafuqishëm, se ndryshimi është i mundshëm dhe se ata vetë mund ta drejtojnë atë.

Projekti për ndryshim "Unë mund t'iu dal ballë sfidave" i fton fëmijët të ndërmarrin veprime, të bëjnë ndryshime për moshatarët e tyre dhe t'i ndajnë ato me fëmijët anakënd botës.

Vizitoni www.dfcworld.com që të filloni

Për të zbritur një pako mësimesh të *projektit për ndryshim*, gjegjësisht një pako të thjeshtë këshillëdhënëse me të cilën të rinjtë do të mund të marrin ndonjë veprim vizitoni

www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Arsimi mund ta transformojë botën

Shtojca 1

Zhvillimi i qëndrueshëm fillon me arsimin

Shtojca 1

Arsimi është fundamental për shpëtim nga varfëria kronike

Shtojca 1

Arsimi ua ofron prindërve njohurinë e duhur në lidhje me praktikat më të mira për shëndet dhe higjienë të fëmijëve të tyre

Shtojca 1

Arsimi iu ofron fëmijëve diturinë e duhur për mënyrat më të mira të ruajtjes së shëndetit

Shtojca 1

Arsimi mund të ndihmojë në promovimin e bujqësisë së qëndrueshëm

Shtojca 1

Arsimi mund të ndihmojë në zhdukjen e urisë në kohën tonë

Shtojca 1

Arsimi mund ta përmirësojë ushqimin e së nesërme

Shtojca 1

Arsimimi i nënave ka shpëtuar jetët e miliona fëmijëve anekënd botës

Shtojca 1

Arsimi është pasaportë që u mundëson femrave qasje në tregun e punës

Shtojca 1

Arsimi iu ndihmon grave të ketë peshë zëri i tyre

Shtojca 1

Gratë e arsimuara kanë më pak gjasa të martohen o se të kenë fëmijë në moshë shumë të re

Arsimi mund ta transformojë botën

Shtojca 1

Familjet e arsimuara kanë më shumë gjasa të përdorin metoda për pastrim të ujit siç është filtrimi ose vlimi

Shtojca 1

Cilësia e arsimit është rritje ekonomike dhe të qëndrueshme

Arsimi i mesëm anekënd botës

Madhësia e territoreve të shteteve është ndryshuar, me qëllim që të paraqitet proporcioni i njerëzve të regjistruar në arsim të mesëm në secilin shtet.

1. Cilat shtete i kanë nivelet më të larta dhe më të ulëta të nxënësve në arsim të mesëm?
2. Cilët pjesë të botës i kanë nivelet më të larta, gjegjësisht cilët pjesë i kanë nivelet më të ulëta të arsimit? Në përgjigjet tuaja mund t'i përdorni si orientimin anët e botës (veri, jug, lindje, perëndim) dhe/ose ekuatorin.
3. A ka ndonjë shtet që ka prerje me modelin e përgjithshëm?

Arsimi i mesëm anekënd botës

Madhësia e territoreve të shteteve është ndryshuar, me qëllim që të paraqitet proporcioni i njerëzve të regjistruar në arsim të mesëm në secilin shtet.

1. Cilat kontinente i kanë nivelet më të larta dhe më të ulëta të shpenzimeve në arsimin fillor?
2. Cilat pjesë të botës shpenzojnë më së shumti, e cilat shpenzojnë më së paku? Mund t'i përdorni si orientimin anët e botës (veri, jug, lindje, perëndim) dhe/ose ekuatorin.
3. A ka ndonjë shtet që ka prerje me modelin e përgjithshëm?
4. A janë të barabarta shpenzimet për arsim fillor anekënd botës?
5. A duhet të jenë? Pse?
6. Çfarë ndikime në arsim kanë këta pabarazi?

Shpenzimet për arsimin fillor anekënd botës

Hartat janë marrë nga ueb faqja Worldmapper. Ato janë hapësira të barabarta në hartograme, ndryshe të njohura si harta me barazim të dendësisë. Hartogramet e riformulojnë çdo territor sipas variablës së dhënë. Më shumë harta dhe më shumë informacione për teknikat dhe të dhënat e përdora mund të gjeni në këtë link (lidhje interneti) www.worldmapper.org.

Arsimi i mesëm anekënd botës

Të dhënat janë nga viti 2002.

Anekënd botës rreth 7 milion fëmijë regjistrohen çdo vit në arsim të mesëm nga 122 milion të mundshëm. Pra vetëm 60% të fëmijëve e ndjekin arsimin e mesëm.

Në Kinë mesatarisht 89% ndjekin arsim të mesëm, mirëpo në Indi numri i tyre është 49%. Të dhënat për Afrikë janë edhe me të ulëta: 45% në Afrikën Veriore, 25% në Afrikën Juglindore dhe 13% në Afrikën Qendrore. Niveli më i ulët është në Niger me vetëm 5% të fëmijëve që e ndjekin arsimin e mesëm.

Numri më i madh i nxënësve të shkollave të mesme është nga Kina, të cilët përbëjnë çerekun e të gjithë nxënësve të shkollave të mesme të botës.

Shpenzimet për arsimin fillor anekënd botës

Të dhënat janë nga viti 2001.

Në vitin 2001, 784 miliard dollarë anekënd botës janë shpenzuar në arsimi fillor, të përshtatur sipas fuqisë blerëse. Territori në të cilin është shpenzuar sasia më e madhe janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës; me 28% të të gjitha shpenzimeve në botë, nga ana tjetër Nigeria arrin vetëm 0.28% të të gjitha shpenzimeve të botës. Nga rajoni në rajon hasen dallim i qartë në mjetet e ndara për arsim fillor të fëmijëve. Shpenzimet mesatare në Japoni, Amerikën Veriore dhe Evropën Perëndimore zakonisht janë tre herë më të larta sesa shpenzimet në rajonet tjera. Afrika Qendrore ka përmasë më të ulët të regjistrimit në shkollë fillore dhe njëkohësisht edhe shpenzime më të ulëta.

Arsimi mund ta transformojë botën

MAP

Kufijtë dhe emrat e paraqitur si dhe skicat e përdora në këtë hartë nuk nënkuptojnë vijat e miratuara të kufijve nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Kufijtë përfundimtar ndërmjet Republikës së Sudanit dhe Republikës së Sudanit Jugor ende nuk janë përcaktuar.

Vijat e ndërprera e paraqesin *Vijën e kontrollit në Xhammu dhe Kashmir* të miratuar mes Indisë dhe Pakistanit. Statusi përfundimtar i *Xhammusë dhe Kashmirit* ende nuk është miratuar nga palët përkatëse.

*** Pa paragjykim për çështjen e sovranitetit.*

***Ekziston kontest ndërmjet Qeverive të Argjentinës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në lidhje me ishujt Falkland (Malvinas)*

Inicialet në kllapa i referohen pushtetit administrativ ose pushtetit të përfshirë në marrëdhënie të marrëveshjes së posaçme